

**STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“Piter Pan” sh.p.k**

Në bazë e në zbatim të ligjit

- Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” me poshtë referohet si “Ligji Per Shoqerite”,
- Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”;
- Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

veprimtaria e shoqërisë **“Piter Pan” sh.p.k.** do të organizohet dhe do të drejtohet sipas këtij Statuti të trajtuar në të njëjtën dokument me Aktin e Themelimit.

**PJESA E PARË
DISPOZITA TË PERGJITHSHME**

**Neni 1
Ortakët**

1.1 Ortakët e shoqërisë janë:

1. **R&M GROUP SH.P.K**, identifikuar me nr. NUIS M01815004H, me adresë në Rrugën e Kavajës, pallatet e shoqërisë “Park Construction Albania”, Godina D, Hyrja A, Tiranë, Shqipëri, me administrator dhe ortak të vetëm z.Laert Kasaj, i biri i Luan dhe Elida, shtetas Shqiptar, lindur më 6 Mars 1985, në Skrapar dhe banues në Tiranë, Shqipëri , mbajtës i letërnjoftimit nr 033676531 dhe nr.personal I50306150V, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.

**Neni 2
Emri**

2.1 Emri i shoqërisë është **Piter Pan sh.p.k** (më poshtë referuar si “Shoqëria ”).


**Neni 3
Selia e Shoqërisë**

- 3.1 Selia e shoqërisë është në Rrugën e Kavajës, **pallatet e shoqërisë ‘Park Construction Albania’, Tiranë, Shqipëri**.
- 3.2 Shoqëria mund te hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, në perputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**Neni 4
Forma ligjore**

- 4.1 Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**.

**Neni 5
Kohëzgjatja**



- 5.1 Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj tregtar për një periudhë të pacaktuar (pakufizuar).

**Neni 6
Objekti i aktivitetit**

- 6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "Piter Pan" sh.p.k, konsiston në: "Ushtrim aktiviteti sportiv, park dhe kënd lojërash për femijë. Snack food dhe pije si pjesë e aktivitetit tregtar. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj aktiviteti tregtar që do të jetë në gjendje t'a ushtrojë. Shoqëria mund të bashkohet dhe të marrë pjesë edhe vullnetarisht në konsorciume për prodhimin dhe tregtinë, si dhe të marrë pjesë në sipërmarrjet e përbashkëta për iniciativa të caktuara të biznesit ose industrisë, etj. Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përbushjen e veprimtarisë së saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi".
- 6.2 Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përbushjen e veprimtarisë së saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**PJESA II
KAPITALI I SHOQËRISE DHE KUOTAT**

**Neni 7
Kapitali i Shoqërisë**

- 7.1 Kapitali i shoqërisë është 100,000.00 (Njëqind mijë) Lekë i marrë përsipër dhe i nënshkruar nga ortaku i vetëm.
- 7.2 Kapitali themeltar është i ndarë në 1 (një) kuotë të vetme, e cila zotërohet nga ortaku si më poshtë :

Ortaku	Kuotat e Nënshkruara	Vlera ne Leke	Perqindja(%)
R&M GROUP SHPK	1	100,000.00	100%
Total	1	100,000.00	100%

- 7.3 Kapitali themeltar eshte vetem ne monedhen vendase, lek.

**III. STRUKTURA DREJTUESE
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE**

Neni 8

Përgjegjësia e kufizuar


- 8.1. Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

**Neni 9
Të drejtat e lidhura me çdo kuotë**

- 9.1. Çdo kuote e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korrensponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

Neni 10
Fitimi dhe kalimi i kuotave

- 10.1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- kontributin në kapitalin e shoqërisë;
 - shitblerjes;
 - trashëgimisë;
 - dhurimit;
 - çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj.
- 10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata do bëhet me shkrim.



Neni 11
Detyrimet e Ortakëve

11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

PJESA IV
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 12
Të drejtat e asamblesë së per gjithshme

- 12.1 Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha cështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.
- 12.3 Vetëm Asambleja e Pergjithshme ka të drejtë të vendlodë për sa më poshtë:
- ndryshime dhe modifikime të Statutit;
 - pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
 - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencioni të dhënë nga ortakët;
 - bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
 - blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
 - hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
 - pjesetimin dhe anullimin e kuotave;
 - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqërise si dhe shpërndarjen e fitimit;
 - blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;



- (k) marrjen me qira, dhënen me qira ose dhënen e cdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
- (l) të vendosë për investimet;
- (m) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
- (n) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
- (o) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
- (p) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pageset mbi largimin e drejtorëve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
- (q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
- (r) emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve, ekspertëve kontabël të autorizuar;
- (s) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- (t) përcaktimin e shpërblimeve për likuiduesit, ekspertët kontabël;
- (u) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët;
- (v) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjen e asamblesë;
- (w) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- (x) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- (y) miratimin e cdo cështje tjeter zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.
- (z) Marrjen e huave ne emër të shoqërisë dhe vendosjen e kushteve të huasë
- (aa) Lidhjen e marrëveshjeve për dhënien e huave.

12.4

Asambleja e përgjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo cështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

Neni 13 Vendimet e asamblesë së përgjithshme

13.1 Vendimet e renditura përsa i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpérndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës.


Neni 14 Thirrja e asamblesë së përgjithshme

- 14.1 Asambleja e përgjithshme do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose në cdo vend tjeter nëse përcaktohet në njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortakët të cilet përfaqësojnë të paktën 20 për qind të totalit të votave ne asamblenë e përgjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e përgjithshme. Në kërkesën drejtar administratorëve mund të përfshihen dhe çështjet e posaçme të rendit të ditës.
- 14.3 Asambleja e përgjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, email , telexi apo faksi jo më pak se



7 (shtatë) ditë përparrë datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e per gjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.

- 14.4 Njoftimi për takimin e asamblesë së per gjithshme do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe cështjet e rendit të ditës.
- 14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezantë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezant në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.



Neni 15


Vendimet e marra në asamblenë e përgjithshme

- 15.1 Vendimet në asamblenë e përgjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në asamblesë e përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merrën vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë së gjysmën e numrit total të votave.
- 15.2 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 15.3 Çdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblesë, të cilat do të janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e asamblese së per gjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëtin rend dite.

Neni 16

Drejtimi i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme do të caktohet nga ortakët.
- 16.2 Do të aprovojen apo refuzohen vetëm ato cështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi cështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët jalin pëlqimin e tyre.



Neni 17
Procesverbali i mbledhjes së asamblese se përgjithshme

- 17.1 Për cdo mbledhje të asamblese se përgjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Prosesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregtar dhe një për secilin ortak. Prosesverbali i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Prosesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.
- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesvebalit dhe shpërndarjen e tij.



PJESA V
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 18
Administrimi i Shoqërisë

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose me shume administratorë, të cilet do të përfaqësojnë Shoqërinë. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 18.2 Administratorët mund të autorizojnë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të vecanta.
- 18.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha cështjet që kanë lidhje me të.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 18.5 Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:
 - 18.5.1 përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
 - 18.5.2 hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
 - 18.5.3 përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;

- 18.5.4 nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- 18.5.5 mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrien e paradhënieve;
- 18.5.6 dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
- 18.5.7 punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- 18.5.8 marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i térheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të térheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet;
- 18.5.9 administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- 18.5.10 mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- 18.5.11 administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin/dhe parimet e ligjit;
- ANE*
18.5.12 administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- 18.5.13 thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- 18.5.14 publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- 18.5.15 administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- 18.5.16 marrin vendime mbi të gjitha cështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.

18.6 Personi i mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë ripërtëritje:

- 18.6.1 **Dorjan Gaçe**, i biri Paskalit, shtetas shqiptar, lindur më 8 Qershori 1990, në Përmet dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr 034071456 me nr.personal J00608036V, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.

PJESA VI VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET



Neni 19
Viti finansiar, pasqyrat vjetore financiare

- 19.1 Viti finansiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë finansiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një të të Dhjetorit.
- 19.2 Në fund të cdo viti finansiar, administratorët do të përmbushin detyrat e mëposhtme:
- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
 - (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
 - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.

- 19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm pëmiratim.


Neni 20
Fitimi i Shoqërisë

- 20.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.
- 20.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e otakëve dhe do të dorëzohet në organet tativore përparrë fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

PJESA VII
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 21
Prishja dhe likuidimi

- 21.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
 - (b) bashkimi me një shoqëri tjeter;
 - (c) vendimi i gjykatës me juridiksim përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
 - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 21.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.



**PJESA VIII
TE PERGJITHSHME**

**Neni 22
Të përgjithshme**

- 22.1 Në rast mosmarrëveshjesh të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiken t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridikSION përkatës.
- 22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 22.3. Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale.

Tiranë, më 11 Maj 2021.



ORTAKU I VETËM

R&M GROUP SH.P.K

Përfaqësuar nga administrator i përgjithshëm

LAERT KASAJ

Laert Kasaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË



NOTER ERMIRA KAPLLANI
ADRESA RR. BULEVARDI "GJERGJ
FISHTA", GODINA KULLA JESHILE
"GORA", KATI 1
TEL: 0696042358

VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE

(VËRETIM NËNSHKRIMI I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME)

Nr. repertori: 1438

Tirane më 11/05/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligi nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligi nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligi nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021054230093170479

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ERMIRA KAPLLANI**



DATE 11/05/2021

NR REP 1438

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 11.05.2021, para meje Notere ERMIRA KAPLLANI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, RR. BULEVARDI "GJERGJ FISHTA", GODINA KULLA JESHILE "GORA", KATI 1, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Shoqëria R&M GROUP, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS M01815004H, me adresë Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga E Kavajes, Pallatet Park Construction Albania, Godina D, Hyrja A, Kat 1, përfaqësuar nga Administratori Laert Kasaj, atësia Luan, amësia Elida, shtetas Shqiptar, lindur në Skrapar dhe banues në TIRANË, me adresë Medar Shtylla; Nd. 32/1; H. 1; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 06/03/1985, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033676531 dhe nr. personal I50306150V.


Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, "Statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "Piter Pan"" bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërmë "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTESE

ERMIRA KAPLLANI



Fq. 1